



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

Nr. 151 datë 09.11.2020

### PËR

### NJË SHITESË NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË KOPSHTEVE DHE ÇERDHEVE

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, nenit 23, pika 12, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Urdhrit Nr.344, datë 19.08.2013 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”, të ndryshuar, vendimit nr. 14, datë 10.3.2004 të Këshillit Bashkiak “Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Qendrës Ekonomike për Zhvillim dhe Edukimit të Fëmijëve”, të ndryshuar; vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### V E N D O S I:

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshteve dhe Çerdheve i shtohen 19 (nëntëmbëdhjetë) punonjës në strukturën organizative dhe numri total i tyre bëhet 799 (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) veta, si edhe 10 punonjës në funksionin e arsimit parashkollor (personeli mësimor) nga transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe numri i përgjithshëm i tyre bëhet 954 (nëntëqind e pesëdhjetë e katër).
2. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshteve dhe Çerdheve për vitin 2020.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtorja e Përgjithshme e Kopshteve dhe Çerdheve.  
Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

### K R Y E T A R

T  
O  
N  
I

G  
O